



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



UNIVERSITETI I MITROVICËS  
UNIVERSITY OF MITROVICA  
ISA BOLETINI  
REKTORATI

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Pranuar më datë: 19.08.2019			
Njesia orig.	Numri	Nr ekzempli	Vlera
	1552		

Data: 14/08/2019

Ref.: 1450/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 76-të të mbajtur më 25.07.2019 mori këtë:

## V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" për periudhën tre vjecare 1 tetor 2019 - 30 shtator 2022:
  - Biznes dhe Menaxhment, me specializim në: Banka, Fnanca dhe Kontabilitet BA, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit:
  - Biznes dhe Menaxhment, MSc, 120 ECTS
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

I. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit më datë 22.05.2019 me ekspertën e akreditimit Istileulova Yelena.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 26.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertës ndërkombëtare të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertja e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit BA Biznes dhe Menaxhment, raporti i ekspertës ndërkombëtare të akreditimit, konstaton se Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertja ka konstatuar se nga gjithsejtë shtatë (7) kapitujt të standardeve të Manualit të Akreditimit, Universiteti i Mitrovicës për këtë program të studimit plotëson pjesërisht 3 nga to ndërsa plotëson substancialisht katër prej tyre, dhe rrjedhimisht ka rekomanduar dhënien e akreditimit.

Sa i përket programit të studimit MSc në Biznes dhe Menaxhment, raporti i ekspertës ndërkombëtare të akreditimit, konstaton se Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" nuk përmbush kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertja ndër të tjera, ka konstatuar këto mangësi të cilat kanë qar në mos dhënien e akreditimit: sipas ekspertës, objektivat e programit Master janë më pak ambicioze sesa ato të programit BA të Fakultetit Ekonomik. Sipas saj, nuk ka theks në hulumtimet që duhet të theksohen në nivelin MA (MSc) në krahasim me programin BA (BSc). Për më tepër ekspertja ka deklaruar se nuk ka qenë e qartë mënyra e hartimit të programit të studimit si dhe arsyeshmëria e tij, përfshirë konsulimi me palë të interesit dhe industri. Cështje tjetër problematike për ekspertën janë profilet apo specializimet e programit të studimit, edhe sa i përket mos konsistencës së tyre të paraqitur në RVV si dhe sa i përket formulimit dhe përmbajtjes së tyre. Sa i përket stafit akademik, ekspertja ka deklaruar se institucioni nuk ka përmendur as në dokumentacion dhe as gjatë vizitës komponentën e hulumtimit e cila është shumë e rëndësishme për një program të studimit master. Po ashtu ekspertja rekomandon, që për specializimet e propozuara stafi akademik duhet të jetë më i kualifikuar sa i përket komponentës së hulumtimit si dhe qasjeve pro aktive të metodave të mësimdhënies. Sa i përket përmbajtjes së procesit akademik, ekspertja ka numëruar vërjetet që kanë të bëjnë me harmonizimin e planprogramit, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të universitetit [si dhe rritjen e fizibilitetit të metodave interaktive të mësimdhënies. Përfundimisht, sipas ekspertës, Universiteti fillimisht duhet të bëjë përmirësimet e duhura në programin e studimit në aspektin e arritjes së konsistencës së tij si dhe në aspektin përmbajtjesor, dhe pas një viti të aplikojë përsëri për akreditim. Në bazë të këtyre të gjeturave, ekspertja nuk ka dhënë rekomandim pozitiv për akreditimin e programit të studimit MA Biznes dhe Menaxhment.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë